



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.28, datë 30.04.2007

**PËR
NJË NDRYSHIM NË NUMRIN E PUNONJËSVE
TË POLICISË BASHKIAKE TË QYTETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “ç”, ligjit Nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake dhe të Komunës”, ndryshuar me ligjin Nr.8335, datë 23.04.1998, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.279, datë 28.04.2005 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.313, datë 1.07.2002 “Për caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë Bashkiake dhe të Komunës”, pika 1, Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë prej 50 punonjësish (4 inspektorë dhe 46 policë), në strukturën e Policisë Bashkiake të Qytetit të Tiranës.
2. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.9, datë 24.02.2006 “Për një ndryshim në numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake të qytetit të Tiranës”, ndryshon sipas strukturës së mëposhtme:

- Kryeinspektor	1
- Inspektorë	26
- <u>Policë</u>	<u>173</u>
Gjithsej	200
3. Efektet financiare të pikës 1 të këtij Vendimi, të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2007.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

SOKOL DERVISHAJ